



PRS.0042

## CORKSEAL T24

Tapë gome hidroekspansive për ndarësit e tubave të formave PVC

### Kodi doganor

3926 9097

### Amballazhimi

- Thes 100 copë

### Aplikimi

- Çekiq

Familja  
Proseal

Linjat e produkteve  
• Aqua  
• Infratech

Përbërësit  
Monokomponent

Tipologjia  
Produkte prej gome hidroekspansive

Kategoritë e përdorimit  
• Ndalim i menjëhershëm i depërtimit të ujit me presion në ndërtesa  
• Hidroizolim i ambjenteve nëntokësore me produkte hidroekspansive  
• Ndërhyrje strukturore mirëmbajtjeje për diga, vaska, ujësjellësa dhe kanalizime hidrike  
• Realizimi i veprave nëntokësore në beton me papërshkueshmëri të lartë

Paraqitja  
Tapë plastike

## Përshkrimi i produktit

CORKSEAL T24 është një pajisje e veçantë për mbylljen hermetike për shpërndarësin e kasetës së tubave e përbërë nga një pjesë e forte me material plastik poliamidik dhe nga një kapak i rrudhosur prej gome hidroekspansive.

## Të dhëna shtesë

Pjesa kryesore e CORKSEAL T24 është e pajisur me lamela speciale që e rrethojnë atë dhe që, nëse futen siç duhet në shpërndarës, sigurojnë një pengesë mekanike të presioneve të larta, në mënyrë që elementi i vulosjes të mos hiqet nga vendi në të cilin ai është i pozicionuar edhe në prani të një shtytjeje negative. Kapaku hidroekspansiv i CORKSEAL T24 ka për qëllim të garantojë vulosjen hermetike të pjesës së brendshme të shpërndarësit të tubave.

## Konsumi

N° 1 CORKSEAL T24 kapak për secilin spacer të formularëve të siguruar, preferohet në anën ku uji ka shtytje pozitive.

## Fushat e përdorimit

Realizim ndërtimesh nëntokësore në beton nëpërmjet kasetave metalike, ku muri është në kontakt të drjtpërdrejtë me shtresa hidroizoluese jashtë vetë muraturës: bodrumeve, tavernave, garazheve nëntokësore, ambjenteve nëntokësore dhe përdhese etj. CORKSEAL T24 është projektuar për shpërndarësit e tubave me diametër të brendshëm prej 24 mm, që zakonisht përdoren në ndërtim.


## Vetitë kryesore

 Diametri:  
24 mm

 I pandezshëm

 I përputhshëm në kontakt me ujin

 Jetëgjatësia:  
24 muaj

 Produkt hidroekspansiv:  
+200 / +900 %

 Ngjyrat në dispozicion  
Blu

## Veçoritë teknike

Lëndë jo helmuese

Lëndë pa aromë

Material alkalino-rezistent

## Shtresat e lejuara

Beton, Shpërndarës i kasetave të tubave prej PVC

IF YOU WANT TO SOLVE IT  
 azichem

www.azichem.com

Përditësimi më: 23/03/2021  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet  
ligjore mund të lexohen në  
www.azichem.it/disclaimer

## Mënyra e përdorimit

Pajisja hermetizuese CORKSEAL T24 duhet të përdoret pas heqjes së kasetave metalike, pra vetëm në shpërndarësit tashmë "në punë" dhe të zhytur në beton. Instalimi i pajisjes hermetizuese duhet të kryhet thjesht duke futur tapën me dorë, brenda çdo shpërndarësi bosh, derisa në fund, dhe pastaj të përfundohet futja me anë të një çekiçi të lehtë derisa të shkojë "deri në rrëzë".

Edhe pse CORKSEAL T24 është studiuar dhe testuar për të përballuar presionet deri në rreth 5 bar në shtytje negative (dmth. të vendosura brenda murit), është e këshillueshme që të aplikohet produkti në shtytje pozitive, pra duke e futur atë nga ana e jashtme e murit, pasi të jetë hequr nga kasetja dhe përpara se të kryhet futja brenda.


Është e këshillueshme që produkti të përdoret në kombinim me shpërndarës jo të "preformuar" (të cilat shpesh kanë ndryshime të diametrit në varësi të modelit dhe që mund të ndikojnë në vulosjen hermetike në presione të larta të pajisjes hermetike. Është e këshillueshme që të përdoren shpërndarës që shiten në shufra që priten në varësi të madhësisë direkt në vendin e punës.

Futja e CORKSEAL T24 në shpërndarës që nuk janë vënë në punë (në mungesë të kontaktit me jashtë) mund të shkaktojë prishjen e vetë shpërndarësit.

Në rastet e zgjerimit me ndryshime shumë të mëdha të volumit (> 500%), dhe në mungesë të kushteve ngushtuese mund të shfaqen plasaritje sipërfaqësore; këto fenomene nuk komprometojnë aspak funksionalitetin e pajisjes hermetike dhe mbi të gjitha nuk ndodhin në kushte normale të punës, kur fenomeni i shtrirjes është në kushte të kufizuara përsa i përket volumit që mund të zërë (brenda shpërndarësit).

## Magazინimi e Ruajtja

Ruajeni produktin në ambalazhimin origjinal, në një mjedis të freskët dhe të thatë, duke shmangur acarin dhe rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Ruajtja e papërshtatshme e produktit mund të shkaktojë humbje të vetive reologjike. Mbrojeni nga lagështia.



## Paralajmërimi, Masa paraprake, Ekologji

Të dhënat e përgjithshme, ashtu si dhe indikacionet dhe sugjerimet për përdorimin e këtij produkti, të paraqitura në këtë fletë teknike të të dhënave dhe mundësisht të shpjeguara dhe me gojë ose me shkrim, përputhen me gjendjen aktuale të njohurive tona shkencore dhe praktike.

Të dhënat teknike dhe të performancës të paraqitura janë rezultat i provave laboratorike të kryera në një mjedis të kontrolluar dhe si të tilla mund të ndryshojnë në lidhje me kushtet e vënies në funksionim.

Azichem Srl nuk merr asnjë përgjegjësi që rrjedhin nga performanca jo e duhur që ka lidhje me përdorimin jashtë rregullave të produktit, ose që ka lidhje me defektet që rrjedhin nga faktorë ose elementë që nuk kanë lidhje me cilësinë e produktit, duke përfshirë këtu dhe konservimin e pasaktë.

Kushdo që synon të përdorë produktin duhet të vendosë, para përdorimit, nëse është i përshtatshëm për përdorimin e synuar, duke marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë e tij.

Karakteristikat teknike dhe të performancës të përfshira në këtë fletë të dhënash teknike përditësohen në mënyrë periodike. Për një konsultë në kohë reale lidhuni me sitin: [www.azichem.com](http://www.azichem.com). Data e rishikimit paraqitet në cep të produktit. Ky njoftim anulon dhe zëvendëson çdo njoftim tjetër të mëparshëm.

Mos harroni se përdoruesi është i detyruar të lexojë Fletën më të fundit të të Dhënave të Sigurisë së këtij produkti, që përmban të dhëna kimike-fizike dhe toksikologjike, parashikimet e rrezikut dhe informacione të tjera me qëllim që të transportojë, përdorë dhe asgjësojë produktin dhe paketimin e tij me siguri të plotë. Për konsultim lidhuni me sitin: [www.azichem.com](http://www.azichem.com).

Ndalohet hedhja e produktit dhe / ose amballazhit të tij në mjedis.

*CORKSEAL T24 prodhohet/shpërndahet nga*



Via Giovanni Gentile, 16/A - 46044 Goito (MN), Itali  
info@azichem.com Tel. +39 0376.604185 /604365 Fax +39 0376 604398



[www.azichem.com](http://www.azichem.com)

Përditësimi më: **23/03/2021**  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet  
ligjore mund të lexohen në  
[www.azichem.it/disclaimer](http://www.azichem.it/disclaimer)